

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a
(Vlerat janë në mijë Lek)
**Pasqyra e konsoliduar e Pozicionit Financiar
Më 31 dhjetor 2017**

	Shënime	31 dhjetor 2017
AKTIVE		
Aktivet afatgjata		
Aktivet afatgjata materiale	6	14,467,929
Aktive afatgjata jo materiale	7	717,064
Parapagime për aktive të tjera afatgjata	8	12,691
Totali i aktiveve afatgjata		15,197,684
Aktivet afatshkurtra		
Inventarë	9	489,542
Llogarite e arkëtueshme	10	2,726,740
Aktive tatimore të shtyra	11	2,670
Llogari të arkëtueshme të tjera	12	65,552
Mjetet monetare në arkë e në bankë	13	85,458
Totali i aktiveve afatshkurtra		3,369,962
Totali i aktiveve		18,567,646
KAPITALI		
Kapitali aksionar	14	6,792,760
Rezerva ligjore		5,220
Fitime të mbartura		316,761
Fitime të mbartura për periudhën 1 Janar - 20 Nëntor 2017		527,844
Rezultati i ushtrimit		(37,135)
Rezerva të tjera		729
Totali i kapitalit		7,606,179
DETYRIMET		
Detyrime afatgjata		
Hua afatgjata	15	5,481,913
Grante	16	465,222
Totali i detyrimeve afatgjata		5,947,135
Detyrime afatshkurtra		
Hua afatshkurtra	17	1,804,645
Llogari të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura	18	2,991,323
Detyrime ndaj personelit	19	57,164
Te pagueshme te tjera		1,008
Detyrime tatimore	20	23,062
Provizione	21	137,130
Totali i detyrimeve afatshkurtra		5,014,332
Totali i detyrimeve		10,961,467
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		18,567,646

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënime shpjeguese të faqeve 9 - 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e konsoliduar e Fitim ose Humbjes dhe të të ardhurave gjithpërfshirëse
Për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017

	Shënime	Për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017
Te ardhurat nga Shitjet	22	304,260
Të ardhura të tjera	23	12,982
Total të ardhura		317,242
Shpenzimet e prodhimit	24	(115,784)
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi		(26,922)
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	25	(97,089)
Rimarrje/(Shpenzime) provizione llogari te arketushme		(9,433)
Rimarrje (Shpenzime) provizione te tjera		5,986
Shpenzime personeli	26	(117,418)
Total shpenzime		(360,660)
Te ardhurat financiare	27	67
Shpenzimet financiare	28	(13,830)
Fitim (humbje) nga kembimet valutore	29	20,246
Fitimi/humbja para tatimit		(36,935)
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin		(200)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin	30	(632)
Tatim i shtyrë detyrim (Aktiv)		432
Fitimi/humbja e vitit		(37,135)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		(37,135)

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 - 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



Pasqyra e konsoliduar e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017

Shënime	Për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017
Flukset e parasë nga aktivitetet operative	
Fitimi (humbja) para tatimit	(37,135)
<i>Axhustime për zërat jo-monetare:</i>	-
Amortizimi	26,922
Rimarrje /renie në vlerë e llogarive të arketushme	(5,986)
Provizione	137,130
<i>Ndryshimi në kapitalin qarkullues</i>	-
Rënie/(rritje) në inventar	(489,542)
Rënie/(rritje) në llogari të arkëtueshme dhe të tjera	(2,786,307)
Rritje/(rënie) në llogari të pagueshme dhe të tjera	2,992,332
Rritje /(Pakesim) i Personelit dhe Detyrimet ndaj shtetit	80,226
Rritje /(Pakesim) i aktiveve tatimore të shtyra	(2,670)
Rritje /(Pakesim) i Huave Afatshkurtra (Kesti Afashkurter)	1,804,645
Mjetet monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative	1,719,615
 Interesa të paguara	
Tatimi mbi fitimin i paguar gjatë vitit	-
Aktivitetet investuese	
Blerje të aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	(15,417,004)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti investues	(15,417,004)
Aktivitetet financuese	
Rregullime të Fitimit(Humbjes) Mbartur	7,835,712
Rritje (Pakesim) i Huave nga Insitucione të Tjera	5,481,913
Rritje (Pakesim) i Detyrimeve për Grante	465,222
Dividendë të paguar	-
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti financues	13,782,847
 Ndryshimi neto i mjeteve monetare	85,458
Mjetet monetare në fillim të periudhës	-
Mjetet monetare në fund të periudhës	85,458

13

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 – 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a


(Vlerat janë në mijë Lek)

Pasqyra e konsoliduar ndryshimeve në Kapital
Për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017

Pozicioni financiar më 21 nëntor 2017 UKT	Kapitali i nënshkruar	Rezerva ligjore	Rezerva të tjera	Fitime të mbartura	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 21 nëntor 2017 HEC	-	-	-	-	-	-
Shtesa në kapital						
Fitimi i mbartur nga 2016 UKT	6,792,760					6,792,760
Fitime të mbartura nga periudha Janar - Nëntor UKT+ HEC		1,352	729	77,358		79,439
Fitim / Humbja e periudhes UKT				316,761		316,761
Rezultati i vitit ushtrimor Hec Lanabregas				527,844		527,844
Krijimi i rezervës ligjore				(40,720)	(40,720)	(40,720)
Dividendët e paguar		3,868		(3,868)	3,585	3,585
				(73,490)	-	(73,490)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	6,792,760	5,220	729	844,605	(37,135)	7,606,179

Pasqyrat financiare të konsoliduara duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese të faqeve 9 – 35, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të konsoliduara së bashku me shënimet shpjeguese më dhe për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017 u aprovuan nga Menaxhimi i shoqërisë më dhe u nënshkruan si më poshtë nga:



Z. Redi Molla
Drejtor i Përgjithshëm

Znj. Aida Sula
Drejtor Ekonomik

1. Informacion i përgjithshëm

1.1 Informacion Ligjor

Pasqyrat financiare të Grupit paraqesin konsolidimin e aktiviteteve të Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a që është shoqëria mëmë dhe HEC Lanabregas Sh.a.

Më datën 27.09.2017 është rregjistruar shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë Sh.a pranë QKB-së me NIPT L72320033P sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr. 8 datë 27.09.2017.

Adresa ligjore UKT sh.a është në: Rruga 5 Maji, pranë Medresesë, Tiranë. Shoqëria është subjekti i rregjistruar në TVSH.

Me vendim nr. 13 datë 23.11.2017 të Aksionerit të vetëm Bashkia Tiranë, të shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a, Bashkia Tiranë është 100% aksioner me kapital aksioner prej lekë 6.792.760.000, aksione 6.792.760 me vlerë nominale Lek 1000/aksion.

Shoqëria ka rregjistruar pranë QKB –së administrator ligjor Z.Redi Molla, me mandat 3 vjeçar, ndërkaj që ajo mbikqyret nga Këshilli i Administrimit.

Shoqëria operon në aktivitetin e furnizimit me ujë të pijshëm të konsumatorëve dhe shitjes së tij. Mirembajtje e sistemit/sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm; prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesës së konsumatorëve, shërbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura dhe shitja e tij, mirëmbajtja e sistemeve të ujërave të ndotura, si dhe impiantëve të pastrimit të tyre.

Pasqyrat e konsoliduara të Grupit përfshijnë periudhën 21 nëntor-31 dhjetor 2017. Shoqëria HEC Lanabregas Sh.a nuk ka përgatitur pasqyra nga data 21 nëntor deri në 31 dhjetor 2017, por për qëllim të krahasueshmërisë është bërë ndarje e përafërt nga pasqyrat e HEC për 2017, për periudhën 21 nëntor deri në 31 dhjetor 2017.

Marrëveshja e Ndarjes

Në bazë të Marrëveshjes së Ndarjes në datën 27/09/2017 u vendos që UKT Sh.a. të ndahet dhe shoqëritë pritëse që do të krijoheshin rishtazi janë si më poshtë:

1. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Tiranë sh.a.,
2. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a.,
3. Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a.

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e shoqërisë që ndahet do të merreshin përsipër nga shoqëritë pritëse sipas zonës së juridiksionit të bashkive respektive dhe me të njëjtat kushte sikur zbatohen ende nga Shoqëria që ndahet.

Ndarja është realizuar në datën 20 nëntor 2017 dhe Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Vorë sh.a. ka marrë në dorëzim të gjitha asetet sipas raportit të ndarjes në të cilin është propozuar ndarja e aktiveve neto midis shoqërive të reja në bazë të bilancit të pa-audituar të shoqërisë në datën 31 dhjetor 2016. Raporti i ndarjes nga eksperti është leshuar në datën 16 shkurt 2017.

Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Bashkia Kamëz sh.a. nuk e ka pranuar vendimin e Asamblese së Përgjithshme të Aksionereve të Shoqërisë UKT Sh.a. "Për miratimin e Projektmarëveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionareve Bashkia Vore dhe Kamëz nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a." dhe ka hapur proces gjyqësor për pavlefshmërinë e këtij vendimi. UKB Kamza nuk ka marrë në dorëzim asetet dhe ato janë të pasqyruara në bilancin e Ujësjetllës Kanalizime Tiranë.

Në Pasqyrën e Ndarjes të Pozicionit Financiar të shoqërisë më 20 nëntor 2017 më poshtë është paraqitur ndarja e shoqërive pritëse e datës 20 nëntor 2017.

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

1.1 Informacion Ligjor (vazhdim)

Pasqyra e Ndarjes të Pozicionit Financiar të shoqërisë më 20 nëntor 2017

AKTIVE	UKT Sh.a. 20 nëntor 2017	UKB Tirane	UKB Vore	UKB Kamez
Aktivitet afatgjata				
Aktivitet afatgjata material	14,286,625	14,084,898	62,905	138,822
Aktive afatgjata jo materiale	717,064	717,064	-	-
Tituj pjesëmarrje	192,398	192,398	-	-
Parapagime për aktive të tjera afatgjata	12,691	12,691	-	-
Totali i aktiveve afatgjata	15,208,778	15,007,051	62,905	138,822
Aktivitet afatshkurtra				
Inventarë	499,570	499,570	-	-
Llogari të arkëtueshme tregtare	2,863,163	2,684,960	20,110	158,093
Aktive tatimore të shtyra	2,238	2,238	-	-
Llogari të arkëtueshme të tjera	136	136	-	-
Parapagimet dhe shpenzimet e shtyra	19,260	19,260	-	-
Mjetet monetare në arkë e në bankë	100,646	100,646	-	-
Totali i aktiveve afatshkurtra	3,485,013	3,306,810	20,110	158,093
Totali i aktiveve	18,693,791	18,313,861	83,015	296,915
KAPITALI				
Kapitali aksionar	2,544,398	2,174,332	81,041	289,024
Rezerva nga rivlerësimi	3,219,601	3,219,601	-	-
Rezerva ligjore	79,745	79,745	-	-
Rezerva statutore	3,681	3,681	-	-
Fitime të mbartura	1,877,667	1,877,667	-	-
Fitimi i ushtrimit	471,872	471,872	-	-
Totali i kapitalit	8,196,963	7,826,898	81,041	289,024
DETYRIMET				
Detyrime afatgjata				
Hua afatgjata	5,576,996	5,576,996	-	-
Grante, të ardhura të shtyra e të tjera detyrime	466,424	466,424	-	-
Totali i detyrimeve afatgjata	6,043,420	6,043,420	-	-
Detyrime afatshkurtra				
Hua afatshkurtra	1,750,755	1,750,755	-	-
Llogari të pagueshme tregtare	2,512,618	2,512,618	-	-
Detyrime ndaj personelit	37,610	37,610	-	-
Detyrime tatimore	13,261	13,261	-	-
Provizione	139,164	139,164	-	-
Diferenca me raportin e ndarjes UKT, Vore, Kamez	-	(9,865)	1,974	7,891
Totali i detyrimeve afatshkurtra	4,453,408	4,443,543	1,974	7,891
Totali i detyrimeve	10,496,828	10,486,963	1,974	7,891
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	18,693,791	18,313,861	83,015	296,915

1. Informacion i përgjithshëm (vazhdim)

1.2 Informacion mbi veprimtarinë

a. Informacion mbi produktet kryesore dhe shërbimet e UKT sha

Liçensa e shoqërisë është rinovuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator i Ujit me numer 21 me vendim numer 28 date 01.07.2013, pas një procesi monitorimi dhe vlerësimi të përmbushjes së të gjitha kërkesave për këtë liçencë nga Enti Rregullator i Ujit në bazë të Ligjit Nr. 8102 datë 28.03.1996 "Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik, largimin dhe përpunimin e ujrave të ndotura".

Veprimtaritë përkatëse të kualifikuar në kategoritë janë:

- Kategorija A, Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
- Kategorija B, Për përpunimin e ujit për konsum publik.

Kategorija C, Për largimin e ujrave të ndotura.

Në zonat e shërbimit të këtij operatori është: Bashkia Tiranë dhe Kamëz, Komunitat: Farkë, Petrelë, Krrabë, Dajt, Bërshull, Baldushk, Vaqar, Zall – Herr, Peze, Kashar Ndroq, Paskuqan.

Përsa bazuar në liçensë UKT ofron shërbimet e mëposhtme:

- i) shpërndarjen e ujit të pijshëm
- ii) instalimin e matësve
- iii) instalimin e pikëlidhjeve me rrjetin
- iv) azhurnimin e rrjetit
- v) largimin e ujrave të ndotura
- vi) shitjen e ujit me botë
- vii) furnizimin me ujë të HEC Lanabregas etj.

1.3 Informacion mbi përthithjen e Shoqërisë HEC Lanabregas Sha në Ujësjellës Kanalizime Sha

Shoqëria "HEC LANABREGAS" sh.a është krijuar si shoqëri anonime shtetërore në 31/08/2011 dhe është rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit Tiranë në 07/09/2011 si rezultat i një operacioni spin-off të aktiveve të prodhimit të energjisë elektrike të Korporatës Elektroenergjitike Shqiptare Sha të përdorura prej saj, në vendndodhjen Lanabregas, Komuna Dajt Tiranë.

Në vijim të kontratës nr 1588 rep-nr 320 kol datë 08/05/2012 "Për Blerjen e Aksioneve të HEC Lanabregas sha", Ligjit 9901 date 14/04/2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" Ujësjellës Kanalizime sha është shndërruar në zotëruesin në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë Hec Lanabregas Sha.

Asambleja e Aksionarëve të UKT sha në datë 16.01.2013 ka aprovuar Marrëveshjen e Bashkimit me përthithje të shoqërive Ujësjellës Kanalizime sha Tiranë dhe HEC Lanabregas sha ku shoqëria Ujësjellës Kanalizime sha Tiranë përthithi shoqërine HEC Lanabregas sha. Ky operacion sipas Marrëveshjes u realizua mbi të dhënat e datës 30 shtator 2012.

Më datë 18/7/2014, shoqëria HEC LANABREGAS sha është rregjistruar si shoqëri me vehte pranë QKR-së me NIPT L41918001E dhe aksioner 100% UKT sha me një kapital prej 10.000.000 lekë sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve nr 13 datë 13/9/2013, me adresë Komuna Dajt Hec Lanabregas me objekt të aktivitetit prodhim i energjisë elektrike, shitja e energjisë elektrike. Shoqëria mundet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

2. Aplikimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të reja dhe të rishikuara (SNRF)

2.1. Standardet dhe interpretimet efektive në periudhën aktuale

Standardet, amendimet dhe interpretimet në vijim, hyjnë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë në 1 Janar 2017 ose pas kësaj date:

- *Përmirësimet vjetore të SNRF (Cikli 2014 - 2016):* SNRF 12 - Shpalosjen e interesave në njësi të tjera
- *SNK 12 Tatimi mbi të ardhurat* (Amendim – Njohja e taksës së shtyrë si aset për humbje të përealizuara)
- *SNK 7 Pasqyra e Flukseve Monetare* (Shpalosjen e Amendimeve fillestare)

Nuk ka patur standarde apo interpretime të reja, të cilat kanë hyrë në përdorim për herë të parë për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2017 ose pas kësaj date, që të kenë efekt të qenësishëm në pasqyrat financiare të kompanisë.

2.2 Standardet dhe interpretimet e emetuara por ende të pa përvetësuar

Ka një numër standardesh dhe interpretimesh të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël të cilat behën efektive në periudhat e ardhshme kontabël dhe që Shoqëria nuk ka vendosur ti përvetësojë më shpejt. Më të rëndësishmet janë:

- *SNRF 9 Blerësit e instrumentave financiar* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date)
- *SNRF 15 Të ardhurat nga kontratat me blerësit* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2018 ose pas kësaj date); dhe
- *SNRF 16 Qiratë* (hyn në fuqi për periudhat që fillojnë nga 1 Janari 2019 ose pas kësaj date)

Shoqëria nuk parashikon standarde të tjera të publikuara nga Bordi Ndërkombëtar i Standardeve Kontabël, që nuk janë në përdorim, të kenë ndikim material në pasqyrat financiare.

- *KIRFN 22 Përkthimin e Monedhave të huaja dhe Vlerësimin në Avancë* (në fuqi më 1 Janar 2018)
- *Amendime të klasifikimeve të SNRF 2 dhe Matja e Transaksioneve me Pagesë Aksionesh* (në fuqi më 1 Janar 2018)
- *Amendime të SNRF 4: Aplikimi i SNRF 9 Instrumentet Financiar me IFRS 4 Kontratat e Sigurimit* (në fuqi më 1 Janar 2018)
- *Amendime të SNA 40: Transfertat e Pasurive Investuese* (në fuqi më 1 Janar 2018)
- *Përmirësimet vjetore të Standardeve SNRF, cikli 2014 – 2016*, që ndeshet me çështjet e SNRF 1 për herë të parë
- *Adoptimi dhe SNA 28 Investime në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta* (në fuqi më 1 Janar 2018)
- *KIRFN 23 Paqartësi mbi Pozicionin e Taksës mbi të Ardhurat* (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- *Amendime të SNRF 9 Karakteristikat e Parapagimeve me Kompensim Negativ* (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- *Amendime të SNA 28: Interesat Afatgjatë në Ortakëri dhe Ndërmarrje të Përbashkëta* (hyn në fuqi më 1 Janar 2019)
- *SNRF 17 Kontratat e Sigurimit* (hyn në fuqi më 1 Janar 2021)

Kompania ka zgjedhur të mos i përvetësojë këto standarde, rishikime dhe interpretime para datës që ato do të bëhen efektive. Kompania parashikon se përvetësimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë në periudhën e aplikimit fillestar të tyre.

(Vlerat janë në mijë Lek)

3. Bazat e përgatitjes

3.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare të UKT Sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të miratuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Kuadri kontabël i aplikuar është i bazuar në politikat kontabël të listuara më poshtë. Më poshtë paraqiten parimet kryesore kontabël të aplikuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

3.2. Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti për Interpretimet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KIRFN") të BSNK-se.

3.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Grupi do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

3.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lek Shqiptar ("Lek"), e cila është monedha funksionale e shoqërisë.

3.5. Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të Grupit konsolidojnë ato të shoqërisë mëmë dhe të shoqërisë së kontrolluar prej saj me 31 dhjetor 2017. Shoqëria e Kontrolluar ka date raportimi me 31 dhjetor 2017.

Të gjitha trasaksionet dhe balancat ndërmjet të shoqërive të Grupit janë eliminuar në konsolidim, duke përfshirë fitimet e përealizuara dhe humbjet nga transaksionet ndërmjet shoqërive të Grupit.

Në rastet kur humbjet e përealizuara në shitjet e aseteve brenda grupit janë stornuar në konsolidim, aktivi është testuar edhe për zhvlerësim nga prespektiva e grupit. Shumat e raportuara në pasqyrat financiare të Shoqërive të Konsoliduara janë përshtatë aty ku është e nevojshme për të siguruar përputhshmërinë me politikat kontabël të miratuara nga Grupi.

Fitimi ose humbja dhe të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të Shoqërive të Kontrolluara të blera apo të shitura gjatë periudhës njihen nga data efektive e blerjes, ose deri në datën efektive të shitjes, sipas rastit.

3.6. Vlerësime dhe gjykime

3.6.1 Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e klientëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të klientëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së klientëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

3.6.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Bazat e përgatitjes (vazhdim)**3.6.3. Zhvlerësimi i inventarëve**

Shoqëria vlerëson gjendjen e inventarit në qarkullim të ulët dhe inventarin i cili ka humbur vlerën e përdorimit për shkak të zhvillimeve teknologjike apo arsyeve të tjera, me synim për të përcaktuar masën e zhvlerësimit të inventarit, bazuar në përdorimin e ardhshëm të tij dhe në llogaritjen e vlerës neto të realizueshme. Në rast se vlera neto e realizueshme e inventarit është më e ulët se vlera kontabël neto, ekziston një tregues që inventari është i zhvlerësuar. Shoqëria përdor gjykimin e saj për të përcaktuar masën e zhvlerësimit.

4. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

4.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	31 dhjetor 2017
EUR/LEK	132.95
USD/LEK	111.10

4.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen me vlerën e drejtë duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë.

Hua të marra

Huatë e marra njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

4.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Programi i blerë që është pjesë përbërëse në funksionimin e një pajisjeje është kapitalizuar si pjesë e pajisjes.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.3. Aktive afatgjata material (vazhdim)

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime me metodën lineare mbi jetën e dobishme të aktivit për ndërtesat, kompjuterat, furniturat dhe pajisje, rrjeti ujësjetellës dhe kanalizimeve dhe mjetet e transportit. Aktivët e marra me qera amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis periudhës së qiramarrjes dhe jetës së tyre të dobishme. Toka nuk amortizohet.

Baza e përlllogaritjes përfshin shumën fillestare të makinerive dhe pajisjeve dhe duke zbritur vlerën e rikuperueshme të aktivit.

Vlerësimi i jetës së aktiveve është bërë duke parë nivelin e lartë të konsumimit dhe dëmtimet në asetet e UKT Sh.a.

iv. Rënia në vlerë

Vlera e mbartur e ndërtesave, makinave dhe pajisjeve kryesore janë testuar çdo vit për rënien e mundshme në vlerë, atëherë kur ngjarjet apo kushtet e gjëndjes financiare tregojnë që shuma e mbartur e këtyre aktiveve nuk mund të rikuperohet.

Në rast se për aktivet identifikohet fakti që mbartin një rënie të vlerës së tyre, atëherë shuma e mbartur në kontabilitet zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme përfaqësohet nga shuma më e madhe midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim, ku kjo e fundit është llogaritur si vlera e skontuara e flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë, të rregulluara nga faktorët e riskut që mbartin.

Për këto arsye grupohen sipas aftësisë së tyre për të gjeneruar flukse hyrëse të parasë bazuar në faktin që këto aktive janë të identifikueshme dhe që gjenerojnë flukse të rëndësishme të mjeteve monetare.

Vlerësimet e flukseve të ardhshme të parasë të përdorur, me vlerën e rënë të aktiveve të lidhura me prodhimin dhe shpërndarjen e produkteve, kryhen duke përdorur vlerësimin e riskut në lidhje me prodhimin dhe performancën e tyre.

Zbritja në vlerë e aktiveve, përveç emrit të mirë, aplikohet sa herë që ngjarjet të cilat kanë ecur në këtë rënie të vlerës ndryshojnë.

v. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.4. Aktivët afatgjatë jomateriale (emri i mirë)

Emri i mirë rezultojn nga transaksioni i përthithjes së HEC nga Ujësjetllës Kanalizime dhe përfaqëson tepërcën midis shumës së paguar dhe vlerës së paguar dhe kapitalit të nënshkruar shoqërisë së përthithur.

Për qëllime të testit të vlerës së Emrit të Mirë, ai alokohet në Njësinë Gjeneruese të Fitimeve të identifikuar dhe që pritet të përfitojn nga sinergjitë e kombinimit të bizneseve. Njësia e Gjenerimit të Fitimeve për të cilën është alokuar Emri i Mirë përfaqëson nivelin më të ulët brenda kompanisë mbi të cilën monitorohet Emri i Mirë.

Emri i i Mirë monitorohet në nivel të raporteve segmentare. Shoqëria njeh humbje nga rënia në vlerë e emrit të mirë mbi baza të llogaritjeve fiskale me metodën lineare.

4.5. Aktive jo financiare

Vlerat kontabël të aktiveve jofinanciare të Shoqërisë janë rishikuar në datën e raportimit për të përcaktuar në qoftë se ka ndonjë tregues zhvlerësimi. Në qoftë se ndonjë tregues i tillë ekziston, atëherë llogaritet vlera e rikuperueshme e aktivitetit. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuarat monetare të ardhshme janë zbritur për vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të pasqyrës dhe risqet specifike për aktivitetin për të cilat vlerësimet e flukseve monetare të ardhshme nuk janë rregulluar.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në qoftë se vlera e mbartur e aktivitetit apo pjesa e burimit të parave e kalon vlerën e rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në të ardhura ose shpenzime.

4.6. Inventarët

Inventarët janë matur me më të voglën midis Kostos Historike dhe Vlerës Neto së Realizueshme. Vlera Neto e Realizueshme është e ardhura e parashikuar nga shitja në një periudhë normale të aktivitetit minus kostot e parashikuara të shitjes. Kostot e inventarit janë përllogaritur duke u bazuar në metodën e mesatares së ponderuar dhe përfshijn shpenzimet e kryera gjatë blerjes së inventarit dhe e dërgimit të tyre në kushtet dhe vendodhjen ekzistuese.

4.7. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

Të ardhurat përfshijn të ardhurat nga shitjet neto dhe të ardhurat nga shërbimet të realizuara nga aktivitetet kryesore të Grupit, duke mos përfshirë tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH). Pjesa më e madhe të shitjeve të Degës gjenerohen nga shitja e shërbimeve të instalimit dhe mirëmbajtjes.

i) Të ardhurat nga shitja e shërbimeve dhe produkteve

Në marrëveshjet për shitjen vetëm të shërbimeve, të ardhurat nga shërbimet e furnizimit me uje të pijshëm dhe shërbimet e kanalizimit njihen në momentin e kryerjes së shërbimit, bazuar në matjen që realizohet të konsumit. Të ardhurat nga shërbimet e mirëmbajtjes dhe azhurnimit, si dhe të shitjes së produkteve: të matësive, librazave të ujit etj, njihen në momentin e realizimit të tyre. Përgjithësisht, të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose që do të arkëtohet. Në rastin kur një pagesë e shtyrë ka një ndikim të rëndësishëm në llogaritjen e vlerës së drejtë, do të llogaritet duke skontuar pagesat e ardhshme. Vlerësimi i arkëtimit të llogarive të arkëtueshme është i rëndësishëm për të përcaktuar nëse do të njihen ose jo të ardhurat ose shpenzimet. Si pjesë e procesit të njohjes së të ardhurave, vlerëson nëse do të rrjedhin përfitime ekonomike të lidhura me transaksionin. Nëse Grupi ka pasiguri nëse do të hyjnë apo jo përfitime ekonomike, njohja e të ardhurave shtyhet dhe njihen mbi baza monetare. Megjithatë, nëse ka pasiguri rrëth mbledhjes së një shume tashmë të përfshirë në të ardhurat, shumën në lidhje me të cilën është e pamundur që të arkëtohet ajo njihet si shpenzim në zërin e kostos së mallrave të shitura.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.7. Të ardhurat (vazhdim)

Sipas vendimit numër 24 të Komisionit Kombëtar Rregullator të Ujit, datë 26.02.2013 "Për një shfuqizim në vendimin e KKR" dhe nr. 29, datë 28.09.2011 "për përcaktimin e llogaritjes së sasisë së ujrave të ndotura", vendosi që sasisë e ujrave të ndotura për çdo klient do të llogariten me 100% të sasisë së ujit të konsumuar.

ii) Të ardhurat nga interesi

Të ardhurat nga interesi njihen në proporcion me kohën duke u bazuar në metodën e interesit efektiv. Kur një llogari e arkëtushme është vështirë për t'u arkëtuar, Grupi zvogëlon vlerën e mbartur deri në vlerën e rikuperueshme, duke konsideruar që flukset e ardhshëm të parashikuara të skontuar me normën origjinale të interesit efektiv të instrumentit, dhe vazhdon të pakësojë zbritjen duke njohur të ardhurat nga interesi. Të ardhurat nga interesi në rastin e huave të cilat kanë rënie të vlerës njihen duke përdorur normën efektive origjinale të interesit.

iii) Të ardhurat nga Grantet

Qeveria e Shqipërisë ose/dhe Organizma Ndërkombëtare ofrojnë Grante shoqërisë në lidhje me realizimin e investimeve në infrastrukturën e rrjeteve. Fillimisht Granti njihet si detyrim në Pozicionin Financiar ndërsa që shuma e Grantit, njihet në të ardhurat me realizimin e investimit ose shpenzimeve për realizimin e tyre. Gjithashtu Bashkitë dhe Komunat mund të japin grante për kompensimin e çmimit të ujit apo shërbimeve të rregulluara, në këto raste të ardhurat njihen në proporcion me sasinë e ujit apo shërbimeve të rregulluara që konsumohen. Në rastin kur ofrohen grante për mbulimin e shpenzimeve të UKTsha ato njihen në të ardhura, në masën e shpenzimit të realizuar.

4.8. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate dhe të ardhura nga veprimtari të tjera jooperative.

4.9. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve. Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë. Shoqëria ka vetëm qira operative.

4.10. Grantet

Grantet që lidhen me aktivet, përfshirë grantet jo monetare me vlerë të drejtë, paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke njohur grantin si të ardhur të shtyrë, e cila njihet si e ardhur në Pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera të përgjithshme në mënyrë sistematike dhe proporcionale përgjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

4.11. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

4. Politikat Kontabël (vazhdim)

4.12. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15%.

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshem (apo të rikuperueshem) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të ketyre aktive dhe detyrime për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet. Aktiviteti tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshem në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

4.13. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

4.14. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhur.

4.15. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

4.16. Aktiviteti dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4.17. Krahueshmëria e informacionit kontabel

Kur është e nevojshme, shifrat krahasuese duhet të axhustohen (rregullohen) në konform me ndryshimet në paraqitje në periudhën aktuale raportuese.

Në bazë të Marrëveshjes së Ndarjes në datën 27/09/2017 vendosi që UKT Sh.a. të ndahet dhe ndarja është realizuar për aktivitetin e shoqërisë në datën 20.11.2017. Pasqyrat financiare të datës 31 dhjetor 2017 i perkasin shoqërisë së re të krijuar në dt. 21.11.2017 e për rrjedhojë paraqiten pa informacion krahasues të datës 31.12.2016 për shkak se kjo shoqëri e re nuk ka ekzistuar përpara datës 21 nëntor 2017.

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit

Kompania kryen supozime dhe bën vlerësime të cilat kanë ndikim në shumën e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Çmuarjet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazuar në eksperiencën e kaluar dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë edhe parashikimet e ngjarjeve të ardhshme të cilat besohet që janë të arësyeshme sipas rrethanave.

5.1 Njohja e të Ardhurave

(i) Të Ardhurat nga shitja e produkteve të rregulluar

Njohja e të ardhurave për klientët të cilët janë objekt matjeje përfshin një vlerësim të vlerës së ujit të konsumuar dhe të tjera shërbime të lidhura midis datës së fundit të matjes dhe datës së fundit të periudhës ushtrimore. Në datën e bilancit kjo shumë është për tu faturuar në datën tjetër të matjes. Drejtimi mendon që perlllogaritja e konsumit për periudhën afërsisht 15 ditore për klientët paraqet besueshëm vëllimin e të ardhurave që realizohen gjatë kësaj periudhe. Megjithatë ndryshimi në këto supozime nuk do të ketë efekte materiale në raportimin e të ardhurave.

(ii) Grantet

Një numër i caktuar grantesh janë përfshirë në librat, të përfituara nga transaksione të ndryshme me donator të ndryshëm. Drejtimi analizon destinacionin dhe dokumentacionin e këtyre granteve. Një shumë e caktuar grantesh kanë qenë dhuruar si kontribut në materiale dhe aktive. Grantet njihen si të ardhura për pjesën e amortizimit të aktiveve për të cilat janë përfutur.

5.2 Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme

Shoqëria llogarit zhvlerësimin për llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmeve të tjera bazuar në humbjet e vlerësuar që rezultojnë nga paafësia e klientëve për të bërë pagesat e detyrimeve të tyre. Vlerësimi është bazuar në analizën e vjetërsisë të llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën historike të nxjerrjes jashtë librave kontabël, cilësinë e klientit dhe ndryshimet në termat e pagesës së klientit kur vlerësohet saktësia e humbjes nga zhvlerësimi për llogaritë e dyshimta. Kjo përfshin supozimet për sjelljen e ardhshme të klientit dhe mbledhjet e ardhshme të parave. Në qoftë se kushtet financiare të klientit përkeqësohen, regjistrimet aktuale të llogarive të arkëtueshme ekzistuese mund të jenë më të larta sesa priten dhe mund të kalojnë nivelin e humbjeve nga zhvlerësimi të njohura deri tani. Kompania testoi llogaritë e arkëtueshme të saj nëse ato kanë një rënie në vlerë në përputhje me politikat e brendshme të Kompanisë.

Metoda e Vlerësimit

Bazuar në politikën kontabël UKT evidenton llogaritë e Arkëtueshme për efekte të vlerësimit të vlerës së drejtë si vijon:

Vlerësuar Individualisht

UKT fillimisht vlerëson nëse ka evidencë të humbjes së vlerës në rang individual dhe që kjo evidencë është materiale në grupin e aktivitetit financiar.

Nëse UKT identifikon sa më sipër që nuk ka evidencë për humbje vlere atëherë ajo e përfshin aktivin në një klasë të aktiveve financiare me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit dhe i vlerëson ata kolektivisht për rënien në vlerë. Aktivitetet që janë vlerësuar individualisht për rënien në vlerë dhe për të cilët humbja nga rënia në vlerë është ose vazhdon të njihet nuk janë përfshirë në një vlerësim kolektiv për rënien në vlerë.

Vlerësuar Kolektivisht

Flukset e ardhshme monetare në një grup të aktiveve financiare që janë vlerësuar kolektivisht për rënien në vlerë parashikohen në bazë të eksperiencës së humbjes historike për aktivitetet me karakteristika të ngjashme të riskut të kreditit me ato në grup.

Në rastet kur UKT nuk ka një eksperiencë humbjeje specifike ose ka një eksperiencë të pamjaftueshme, atëherë përdor eksperiencën e shoqërive që operojnë në të njëjtin treg.

5. Çmuarje dhe gjykime kritike të kontabilitetit (vazhdim)

5.2 Rënia në vlerë e llogarive të arkëtueshme (vazhdim)

Humbjet janë rregulluar në bazë të të dhënave aktuale të vëzhguara për të reflektuar efektet e kushteve aktuale të cilat nuk kanë ndikuar periudhën në të cilën është bazuar eksperiencia e humbjes historike dhe të mënjanojë efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht.

Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare të parashikuara reflektojnë dhe janë lidhur në mënyrë konsistente me ndryshimet e të dhënave të lidhura nga periudha në periudhë (të tilla si normat

papunësisë, çmimet e pronës, çmimet e produkteve, fuqia paguese ose faktorë të tjerë që janë tregues të humbjeve të shkaktuara në grup dhe magnitudës së tyre).

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për flukset e ardhshme të parashikuara janë rishikuar rregullisht për të zvogëluar ndonjë diferencë midis humbjes së parashikuar dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

Vlerësimi i Llogarive të Arkëtueshme

Bazuar në specifikën e aktivitetit të Kompanisë si duke marrë në konsideratë politikat e UKT sh.a.për vjeljen e detyrimeve të prapambetura me vështirësi arkëtimi, Sektori i Menaxhimit të Riskut, në varësi të mënyrës së matjes së konsumit të ujit dhe moshës së debisë, ka klasifikuar portofolin e debisë sipas kategorive të abonentëve në 4 klasa Risku.

Sipas mënyrës së matjes për çdo kategori abonenti dhe moshës së debisë, është klasifikuar debia deri më datë 31.12.2017 sipas klasave të riskut të përcaktuara dhe në bazë të kësaj është përlogaritur vlera e provigjonimit.

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në mijë Lek)

6. Aktivet afatgjata materiale

	Toka	Ndertesë	Rrjeti Ujësjetllës	Rrjeti Kanalizim	Makinë dhe Pajisje Pune	Mjete Transporti	Pajisje zyre	Punime ne proces	Asete ne magazine	Total
Vlera kontabel me 21 Nëntor 2017	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Transferim UKT	2,094,752	4,511,951	3,225,480	814,438	137,034	245,763	234,671	3,789,713	73,303	15,127,105
Transferim UKK	7,434	3,060	170,355	-	1,146	-	-	-	-	181,996
HEC Lanabregas	26,051	51,817	-	-	102,168	-	2,090	47,334	-	182,126
Blerjet UKT	-	-	-	446	2,796	-	29,989	-	-	80,565
Blerjet HEC	-	6,123	-	-	8,770	3,552	690	-	-	19,135
Transferime & Sisteme UKT	-	97,182	16,948	-	4,195	-	(18)	(114,130)	(4,177)	-
Transferime & Sisteme 231	-	97,182	16,948	-	-	-	-	(114,130)	-	-
Transferime & Sisteme 219	-	-	-	-	4,195	-	(18)	-	(4,177)	-
Vlera kontabel me 31 Dhjetor 2017	2,128,237	4,670,133	3,412,784	814,884	256,109	249,315	267,422	3,722,917	69,126	15,590,927
Amortizimi i akumuluar 21 Nëntor 2017	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtese amortizimi Tirane	-	327,624	404,395	79,817	54,582	89,978	68,075	-	12,836	1,037,307
Shtese amortizimi Kamëz	-	436	42,105	-	633	-	-	-	-	43,174
HEC Lanabregas	-	971	-	-	4,924	-	270	-	-	6,165
Amortizimi 2017	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Amortizimi Dhjetor 2017 UKT	-	7,203	9,388	2,063	1,599	2,426	2,759	-	-	25,439
Amortizim Dhjetor 2017 UKK	-	9	896	-	12	-	-	-	-	917
Amortizim Dhjetor 2017 HEC	-	651	-	-	3,372	533	541	-	-	5,097
Amortizimi i akumuluar 31 Dhjetor 2017	-	336,895	456,785	81,880	65,122	92,937	71,645	-	12,836	1,118,099
Zhvlerësimi 20 Nëntor 2017	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Zhvlerësimi UKT	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Shtese zhvlerësimi Tirane	-	-	-	-	4,762	-	-	-	138	4,900
Zhvlerësimi 31 Dhjetor 2017	-	-	-	-	4,762	-	-	-	138	4,900
Vlera Neto Kontabel 31 dhjetor 2017 UKT + HEC	2,120,803	4,330,622	2,828,645	733,004	185,724	156,379	195,776	3,722,917	56,153	14,330,024
Vlera Neto Kontabel 31 dhjetor 2017 Kamëz	7,434	2,616	127,354	-	501	-	-	-	-	137,905
Vlera Neto Kontabel 31 dhjetor 2017	2,128,237	4,333,238	2,955,999	733,004	186,225	156,379	195,776	3,722,917	56,153	14,467,929

(Vlerat janë në mijë Lek)

7. Aktive afatgjata jo materiale

Aktive afatgjata jo materiale më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Emri i mirë-HEC	717,064
	<u>717,064</u>

8. Parapagime për aktive të tjera afatgjata

Parapagime për aktive të tjera afatgjata më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
AAGJ Parapagime për aktive të patrupëzuara	12,691
	<u>12,691</u>

9. Inventarë

Balanca e inventareve më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Materiale – rrjetet	363,422
Pjesë këmbimi	46,363
Materiale konsumi	33,457
Materiale kancelari	7,583
Kimikate	2,734
Karburant	6,828
Inventar i imët	18,871
Të tjera	21,112
Materiale jashtë përdorimit	45,521
Humbje vlere e aktivitet afatshkurtër	(56,349)
	<u>489,542</u>

Lëvizjet në zhvlerësimin e inventarit:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Gjendja më 21 nëntor zhvlerësimi materialeve	44,017
Gjendja më 21 nëntor zhvlerësimi materialeve te tjera	9,435
Gjendja më 21 nëntor zhvlerësimi inventar i imët	2,897
Rimarrje për vitin	-
Zhvlerësimi për vitin	-
Gjendja më 31 dhjetor	<u>56,349</u>

10. Llogari të arkëtueshme

Balanca e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Konsumator familjar	2,253,577
Subjekte private	616,450
Ente buxhetore	114,851
Komuna/ Njësi administrative	152,156
Të tjerë	135,601
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme	(740,328)
Llogari te arkëtueshme neto UKT	2,532,307
Klientë të UKB Kamëz pas ndarjes	285,966
Zhvlerësim i llogarive të arkëtueshme UKB Kamëz	(128,263)
Llogari të arkëtueshme neto Kamez	157,703
Llogari te arkëtueshme neto te shoqerise Mëmë UKT	2,690,010
Llogari te arkëtueshme neto te HEC Lanabregas	36,730
	2,726,740

11. Aktive tatimore të shtyra

Balanca e aktiveve tatimore të shtyra më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Aktive tatimore të shtyra	2,670
	2,670

12. Llogarite e tjera e arkëtueshme

Llogarite e tjera e arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paradhënie për personelin	9,559
Zhvlerësime për debitorë personeli	(9,527)
Te tjera kerkesa te arkëtushme	26,362
Tatim mbi fitimin HEC	1,471
Parapagim per tatim fitimin 2017 niptit te vjeter J620050020	22,947
TVSH e zbriteshme nipti i ri L72320033P	2,672
Pagesa TVSH detyrim e niptit te vjeter J620050020	6,743
Kërkesa për arkëtim	5,325
	65,552

13. Mjetet monetare në arkë e në bankë

Balanca e mjetet monetare në arkë e në bankë të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Likuiditete në bankë	70,570
Mjete monetare në tranzit	14,888
	85,458

14. Kapitali

Kapitali i shoqërisë më 31 dhjetor 2017 është në vlerën 6,792,760 mijë Lekë.

	31 dhjetor 2017
Numri aksioneve	6,792,760
Vlera nominale	1
	6,792,760

15. Hua afatgjata

Balanca e huave afatgjata të shoqërisë më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2017
Bovilla - Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID -95/007/00	629,410
Konventa Financiare 13 Mld Lit - F.ROT/AID-94/006/00	322,334
Konventa Financiare 53.2 Mld Lit - F.ROT/AID-94/004/00	2,221,442
Konventa Financiare 6.8 Mld Lit - F.ROT/AID-99/010/00	466,840
Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit - F.ROT/AID-98/001/00	43,196
Kredia e Shen Merise nga BKT	1,138,325
Kredia e HEC Lanabregas nga BKT	660,366
	5,481,913

Gjatë periudhës 1993-2001, Qeveria e Shqipërisë, në vijim të planit të përbashkët të bashkëpunimit me Qeverinë e Republikës Italiane, nëpërmjet Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, ka firmosur me Zyrën e Bashkëpunimit Italian, një sërë kontratash. Bazuar në këto kontrata, është e përzgjedhur Banka Kombëtare Tregëtare (BKT) si bankë bazë për financimin e objektivit të këtyre kontratave.

Në vijim të asaj më sipër, BKT dhe Njësia e Menaxhimit të Projekteve të Huaja dhe /ose Ministria e Financave, janë palë e kontratave të kredisë së akorduar me UKT për zhvillimin e rrjetit të saj dhe asistencën teknike.

Përdorimi i kredive kryhet nga kredimarrësi kryesor UKT-ja por edhe nga Ministria përkatëse që ka firmosur kontratën. Si rrjedhojë, UKT detajon veçmas tërheqjet që janë realizuar prej saj, si dhe ato që kryhen prej Ministrive.

Informacioni për secilën kredi detajohet si më poshtë:

Bovilla –Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID-95/007/00

E nënshkruar më 20.06.1996 midis Bankës Kombëtare Tregtare të Shqipërisë dhe Njesisë së Drejtimit të Projektit pranë Ministrisë në Ndërtimit dhe Turizmit dhe Ndërmarrjes së Ujësjetllësit Tiranë, për shumën prej 22.000.000.000 Lireta italiane. Keto kredi janë të konvertuara në euro sipas kursit të konvertimit të lireta italiane në euro 1,936 në datën 28.02.2002. Afati i kthimit të huasë është 30 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë :

1. Ndërmarrja e Ujësjetllësit Tiranë do të paguajë huadhënësit një normë vjetore interesi prej 1% , e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore .
2. Ndërmarrja e Ujësjetllësit Tiranë do të fillojë të shlyejë pjesën e principalit pas 12 viteve të bërjes efektive të huasë, i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Ndërmarrja e Ujësjetllësit Tiranë do të paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur, i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.
4. Të gjitha detyrimet e ndërmarrjes së Ujësjetllësit Tiranë do të paguhet në monedhën në të cilën është dhënë huaja, ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.
5. Në rast se ndërmarrja e Ujësjetllësit Tiranë nuk mund të përmbush detyrimin e sa për të bërë pagesat në lidhje me principalin dhe interesin ,atëherë huadhënësi në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Financave do të kërkoj buxhetit të shtetit të paguajë shumat përkatëse.

15. Hua afatgjata (vazhdim)

Konventa Financiare 13Mld Lit-F.ROD/AID-94/006/00

E lidhur më datën 05.04.1995 midis Bankës Kombëtare Tregëtare të Shqipërisë (BKTSH) që do të veprojë si bankë agjente në emër dhe për llogari të qeverisë dhe ndërrmarjes Ujësjetllësit Tiranë, për shumën prej 13.000.000.000 lireta. Keto kredi janë te konvertuara ne euro sipas kursit te konvertimit te lireta italiane ne euro 1,936 ne daten 28.02.2002.

Kushtet e huasë:

1. Afati maksimal i kthimit brenda 30 viteve. Ky afat do të jetë i negociueshëm mbi bazën e gjykimit që do të bëjë BKTSH sipas gjendjes ekonomiko-financiare të ndërrmarjes në të ardhmen.
2. Ndërrmarja e Ujësjetllësit Tiranë do të filloj të shlyej pjesën e principalit pas 10 viteve. Për këtë periudhë interesi do të paguhet.
 - Norma vjetore të Bankës Italiane 1%
 - Kthimi i kredisë dhe interesave do të bëhet me këste 6 mujore
 - Kthimi i kredisë do të bëhet në të njëjtën valutë me të cilën është dhënë kredia pse në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën bëhet shlyerja
 - Ndërrmarja e Ujësjetllësit Tiranë do ti paguajë huadhënësit një komision prej 0.75 % të huasë së përdorur i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë

Konventa Financiare 6.8 Mld Lit-F.ROT/AID-99/010/00

E lidhur më datën 18.09.2000 midis Bankës Kombëtare Tregëtare Shqipëtare dhe Ujësjetllësit Tiranë, për shumën prej 6.800.000.000 litera Italiane. Keto kredi janë te konvertuara ne euro sipas kursit te konvertimit te lireta italiane ne euro 1,936 ne daten 28.02.2002. Afati i kthimit të huasë është 35 vjet nga data e bërjes efektive të huasë sipas Konventës Financiare të lidhur midis qeverisë Italiane përfaqësuar nga Mediocredito Centrale dhe qeverisë Shqiptare përfaqësuar nga Banka Kombëtare Tregëtare.

Kushtet e huasë :

1. Norma vjetore e interesit prej 0.5% ,do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore të llogaritur mbi tepricën e kredisë.
2. Huamarrësi do të filloj shlyerjen e pjesës principale të huasë pas 294 muajve të bërjes efektive të saj ,i pagueshëm 2 herë në vit me këstë 6 mujore.
3. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhet në monedhën në të cilën është dhënë huaja ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.

Konventa Financiare 53.2 Mld Lit-F.ROT/AID-99/004/00

Lidhur në bazë të ligjit Italian nr 49, datë 26 shkurt 1987 midis qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Mediocredito Centrale-Istituto Centrale per il Credito a Medio Termine S.P.A për shumën prej 53.200.000.000 lireta. Keto kredi janë te konvertuara ne euro sipas kursit te konvertimit te lireta italiane ne euro 1,936 ne daten 28.02.2002. Equivalenti ne euro eshte i barabarte me shumen 27,475,507 Euro. Nga kjo vlere janë disbursuar vetem 16,708,850.

Kushtet e huasë:

1. Kthimi në 22 kështe 6 mujore të barabarta dhe të njëpasnjëshëm ku afati i pagimit të këstit të parë mbaron 294 muaj pas datës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente Financiare.
2. Përqindja e interesit 0.5 % interes nominal vjetor i cili do të paguhet në fund të 6 mujorit i cili fillon nga data e cdo përdorimi
3. Destinacioni : Realizimi i një projekti rehabilitimi i rrjetit uhor të Tiranës dhe asistencë teknike në administrimin e ndërrmarjes së ujrave për përmirësimin e administrimit financiar dhe investimet që lidhen me këtë fushë.
4. Valuta e lëvrimin të kredisë: Kredia do të lëvrohet në lireta italiane me kursin e këmbimit të Bankës Italiane.

15. Hua afatgjata (vazhdim)

Projekti COMM'98-Konventa Financiare 22 Mld Lit-F.ROT/AID/98/001/00

E lidhur më datën 25.08.1998 midis Bankës Kombëtare Tregëtare dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Ujësjetllësve për shumën 974.042.799 lireta Italiane dhe ka për objekt përdorimin e huasë për elektropompa dhe materiale për ndërrmarjet e ujësjetllësve. Keto kredi janë të konvertuara në euro sipas kursit të konvertimit të lireta italiane në euro 1,936 në datën 28.02.2002. Afati i kthimit të huasë është 18 vjet nga data e bërjes efektive të huasë.

Kushtet e huasë:

1. Norma vjetore e interesit prej 1% , do të jetë e pagueshme 2 herë në vit me këste 6 mujore të llogaritur mbi tepricën e kredisë.
2. Shlyerja e principalit të huasë do të fillojë pas 150 muajve të bërjes efektive të huasë ,principal ky i pagueshëm 2 herë në vit me këste 6 mujore.
3. Huamarrësi do të paguajë huadhënësit një komision prej 0.75% të huasë së përdorur ,i pagueshëm në momentin e përdorimit të huasë.
4. Të gjitha detyrimet e huamarrësit do të paguhet në monedhën në të cilën është dhënë huaja ,ose në lekë e konvertuar me kursin e ditës në të cilën do të bëhet shlyerja.

Kredia nga BKT për shfrytëzimin e burimeve të Shën Mërisë

E lidhur më datën 31.07.2015 mes palëve: Banka Kombëtare Tregtare Sh.a dhe Ujësjetllës Kanalizim Tiranë Sh.a për shumën 1.000.000.000 lekë e cila do të përdoret për rikonceptimin e skemës së shfrytëzimit të burimeve të Shën Mërisë.

Dorëzanës: Shoqëria "HEC LANABREGAS".

Kushtet e huasë:

1. Si kusht paraprakë kredimarrësi ka rënë dakord të paguajë shumën e kredisë dhe interesin mbi të.Disbursimi do të bëhet në cdo rast ,vetëm pas paraqitjes së kopjes së faturës dhe të situacionit të punimeve të kryera.
2. Kredimarrësi do të hap një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregëtare , në të cilën banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
3. Kredimarrësi do të paguajë një komision angazhimi prej 0.4% ,mbi vlerën totale të kredisë e pagueshme para ditës së disbursimit. Në rast se rezultojnë pjesë të papërdorura të kredisë pas një muaji një komision prej 2% ,mbi bazë vjetore ,e përllogaritur mbi masën e papërdorur të kredisë deri në përfundim të kësaj periudhe.
4. Në rast të mospagimit të komisioneve dhe interesit, Banka ka të drejtë të aplikoj një penalitet prej 4% në muaj, mbi shumën e papaguar të komisionit dhe interesit.
5. Në rast se kredimarrësi është në pamundësi për të ripaguar në kohë kështin e maturuar, Banka përveç normës së interesit normal ka të drejtë të aplikoj penalitet në masën 4% në muaj, i llogaritur mbi detyrimin e kështit të rradhës së papaguar.
6. Gjendja e fundit financiare e kredimarrësit tregon që raporti: Detyrime/Kapitale të veta është më i madh se 2:1.

Kredia për blerjen e HEC Lanabregas nga BKT

E lidhur më datën 30.05.2012 midis palëve Banka Kombëtare Tregëtare dhe Ujësjetllës Kanalizime Sh.a për shumën prej 2.130.000.000 leke me anë të së cilës do të financojë blerjen e "HEC LANABREGAS".

Kushtet e Huasë:

1. Kredimarrësi do të hapë një ose më shumë llogari pranë Bankës Kombëtare Tregëtare në të cilën banka do të bëjë disbursimin e shumave përkatëse të kredisë dhe nëpërmjet së cilës do të bëhet ripagimi i tyre.
2. Kredimarrësi garanton që kredia do të përdoret për qëllimin e marrjes së huasë, në të kundërt banka ka të drejtë të kërkojë menjëherë rikthimin e kredisë dhe interesave të akumuluar, ose mund të aplikojë 1% penalitet mbi shumën fillestare të kredisë.

16. Grante

Balanca e granteve, të ardhurave të shtyra e të tjera detyrime më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Grante afatgjata	463,122
Grante afatgjata Kanalizim	1,777
Grante dhurata pajisje informatike	323
	<u>465,222</u>

17. Hua afatshkurtra

Balanca e huave afatshkurtra më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Hua - këste të paguar Ministria	1,311,898
Hua- pjesa e papaguar e interes	31,010
Hua afatshkurtër HEC	193,278
Hua - pjesa afatshkurtër e detyrimit afatgjatë	137,831
Hua - interesa të përlllogaritura	11,521
Hua afatshkurtër Shën Mëri	119,107
	<u>1,804,645</u>

18. Llogari të pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura

Balanca e llogarive te pagueshme dhe detyrime të përlllogaritura më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Investime afatgjata	541,696
Shërbime dhe mallra	1,345,508
Fatura të pambërritura	41,016
Furnitorë për garanci punimesh	204,257
Debitorë/Kreditorë të tjerë	274,139
Detyrime ndaj OSHEE principal	34,141
Detyrime ndaj OSHEE kamatvones	211,364
Detyrime të përlllogaritura Bashkia Tiranë	60,522
Taksë pastrimi Bashkia Tiranë	164,561
Taksë ndërtese Bashkia Tiranë	37,208
Taksë e ndikimit në infrastrukturë	43,924
Taksë pastrimi Komuna Paskuqan	1,894
Të ardhura të llogaritura dhe të periudhave të ardhshme	31,093
	<u>2,991,323</u>

19. Detyrime ndaj personelit

Balanca e detyrimeve ndaj personelit më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Paga për t'u paguar	55,599
Detyrime të tjera	565
	<u>57,164</u>

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a

Shënime mbi pasqyrat financiare të konsoliduara më dhe për periudhën 21 nëntor - 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në mijë Lek)

20. Detyrime tatimore/ Detyrime ndaj Shtetit dhe ISSH

Balanca e detyrime tatimore/ detyrime ndaj shtetit dhe ISSH më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2017
Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	17,725
Tatim mbi të ardhurat personale	4,262
TVSH per tu paguar	1,552
Të tjera tatim taksa	523
	23,062

21. Provizione

Balanca e provizioneve më 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2017
Provizione për çështje gjyqësore	137,130
	137,130

22. Të ardhura nga shitjet

Balanca e të ardhura nga shitjet për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga konsumatorë familjar	114,188
Të ardhura nga subjekte private	47,135
Të ardhura nga institucione buxhetore	22,616
Të ardhura nga institucione jo - buxhetore	4,652
Të ardhura shitje uji Hec + KESH	32,863
Të ardhura nga tarifa fikse e shërbimit	23,738
Të ardhura shitje uji me shumicë	3,198
Të ardhura nga klientë të veçantë	3,205
Të ardhura shitje uji me bote dhe shitje uji	31
Të ardhura nga pikëlidhjet	651
Të ardhura vendosje matësash	17,580
Të ardhura azhurnime rrjeti	863
Të ardhura të tjera	5,771
Të ardhura nga prodhimi i aktiveve	23,096
Të ardhura nga tarifa e pastrimit	4,673
	304,260

23. Të ardhura të tjera

Balanca e të ardhura te tjera për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Të ardhura nga kamatvonesa, gjoba e penalitete	11,780
Të ardhura nga grantet afatgjata	1,202
	12,982

24. Shpenzimet e prodhimit

Balanca e shpenzimeve të prodhimit për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Shpenzime materiale të para - mirëmbajtje rrjeti	33,017
Shpenzime materiale – kimikate	2,667
Shpenzime të tjera - karbon	6,667
Shpenzime kancelarie	1,726
Shpenzime energjie elektrike	57,728
Shpenzime materiale – matësas	6,548
Shpenzime karburanti	6,092
Lënda e parë e materiale të konsumueshme HEC	1,339
	115,784

25. Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative

Balanca e shpenzimeve të përgjithshme dhe administrative për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Taksa Tatime të ngashme dhe tarifa të tjera	2,143
Marketing dhe të ngjashme	14,117
Transferta, udhetime	875
Shpenzime të përgjithshme	1,449
Penalitete Gjoka	8,432
Shpenzime telefonike ,postare ,internet	125
Shërbimi i rojes private	58,872
Te tjera	916
Shpenzime mirëmbajtjeje dhe riaprimë	167
Qera	3,566
Shpenzime printime dhe fotokopje	3,019
Shpenzime kerkimore	3,408
	97,089

26. Shpenzime personeli

Balanca e shpenzimeve të personelit për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Shpenzime për paga	81,026
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	14,484
Kompensim ushqimore	7,642
Shpërblime dhe të ngjashme	14,266
	117,418

(Vlerat janë në mijë Lek)

27. Te ardhurat financiare

Të ardhurat financiare për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Të ardhura të tjera financiare	67
Totali	67

28. Shpenzimet financiare

Shpenzimet financiare për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Shpenzime interesa - Kreditë 22 Mld FROT/AID-95/007/00	901
Shpenzime interesa - Kredia 13 Mld FROT/AID-94/006/00	455
Shpenzime interesa - Kredia 53.2 Mld FROT/AID-99/004/00	1,316
Shpenzime interesa - Kredia 6.8 Mld FROT/AID-99/010/00	277
Shpenzime për interesa – HEC	4,810
Shpenzime interesa - Kredia comm 98.22 Mld FROT/AID-98/001/00	58
Shpenzime interesi për rikonceptimin e burimeve të Shën Mërisë	6,013
	13,830

29. Fitim (humbje) nga kembimit valutore

Fitim (humbje) nga kembimit valutore për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	Për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017
Fitim nga këmbimet valutore	20,255
Humbje nga kembimet valutote – Administrata	(9)
	20,246

30. Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin për periudhën 21 nëntor – 31 dhjetor 2017 paraqitet si më poshte:

	31 dhjetor 2017
Fitimi (Humbja) Kontabel (A)	(36,935)
E Ardhura e patatueshme (B)	5,986
Zhvlerësime Tej Normave Fiskale	2,456
Zhvlerësime Tej Normave Fiskale	423
Gjoba Penalitete e te ngjashme	8,432
Provigjone per risqe e Shpenzime	9,433
Shpenzime perfaqesimi	-
Shpenzime te cilat jane me dokumenta jo te rregullt	1
Vlera Kontabel Neto Aktiveve	-
Shpenzime te panjohura (C)	20,745
Diferenza e Panjohur per efekte tatim fitimi (C-B)	14,759
Humbja Fiskale e mbartur	-
Fitimi (Humbja) e Tatueshme	(22,176)
Shpenzimi (Perfitimi) Tatimor	632

31. Manaxhimi i riskut financiar

Detyrimet financiare kryesore të Shoqërisë përbëhen nga llogaritë e pagueshme dhe të tjera detyrime. Qëllimi kryesor i këtyre detyrimeve financiare është të financojnë operacionet e Shoqërisë dhe të sigurojnë garanci për mbështetjen e operacioneve. Shoqëria ka hua dhe llogari të arkëtueshme, mjete monetare dhe depozita afatshkurtra që sigurohen drejtpërdrejtë nga operacionet e saj. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të tregut, riskut të kreditit dhe riskut të likuiditetit.

Manaxhimi i lartë i Shoqërisë mbikqyr manaxhimin e këtyre risqeve.

Risku i tregut

Risku i tregut është risku që vlera e drejtë e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në çmimet e tregut. Çmimet e tregut përfshijnë katër lloje risqesh: risku i normës së interesit, risku i kursit të këmbimit, risku i çmimit të mallrave dhe risqe të tjera të çmimeve, të tilla si risku i çmimit të kapitalit. Instrumentat financiar të prekur nga risku i tregut përfshijnë huatë, kreditë dhe depozitat.

Risku i normave te interesit

Risku i normës së interesit përbëhet nga risku që vlera e flukseve monetare të ardhshme të një instrumenti financiar do të variojë për shkak të ndryshimeve në normat e interesit në treg dhe riskut që maturitetet e aktiveve që mbartin interes të ndryshojnë nga maturitetet e detyrimeve që mbartin interes të përdorura për të financuar ato aktive. Zgjatja kohore përgjatë të cilës norma e interesit e një instrumenti financiar është fikse, përcakton se në çfarë mase është e ekspozuar ndaj riskut të normës së interesit.

31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i normave të interesit (vazhdim)

2017	Nuk mbartin interes	Mbartin interes	Totali
Aktivet financiare			
Mjetet monetare në arkë dhe bankë	85,458	-	85,458
Llogarite e arketueshme	2,726,740	-	2,726,740
Totali aktive financiare	2,812,198	-	2,812,198
 Llogarite e pagueshem dhe detyrime të perlllogaritura	 2,991,323	 -	 2,991,323
Detyrime ndaj personelit	57,164	-	57,164
Detyrime tatimore	23,062	-	23,062
Provizione	137,130	-	137,130
Huamarrje afatshkurter	-	1,804,645	1,804,645
Huamarrje afatgjata	-	5,481,913	5,481,913
Grante	465,222	-	465,222
Totali detyrime financiare	3,673,901	7,286,558	10,960,459
 Hendeku i normës së interesit	 (861,703)	 (7,286,558)	 (8,148,261)

Risku i kreditit

Risku i kreditit është risku që një palë tjetër nuk do të jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj që rrjedhin nga një instrument financiar ose marrëveshje klienti, duke çuar kështu në një humbje financiare. Shoqëria është e ekspozuar ndaj riskut të kreditit për shkak të aktiviteteve operationale të saj (pikë së pari prej llogarive të arkëtueshme) dhe prej aktiviteteve të saj financuese, që përfshijnë depozitat me bankat dhe institucionet financiare, transaksionet në monedha të huaja dhe instrumenta të tjerë financiare.

Risku i kreditit është i kufizuar në vlerën kontabël të aktiveve financiare në datën e raportimit.

Provizionet për kërkesat tregtare të vonuara njihen duke u bazuar në vlerësimet e shumave të parikuperueshme në bazë të eksperiencës së mëparshme në mosarëtim nga klientët dhe një analize e pozicionit financiar të palës tjetër. Shoqëria vlerëson rrezikun e cilësisë së kreditit të klientit dhe vlerëson limitet e kreditit sipas klientëve.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që Shoqëria mund të mos jetë në gjendje të paguajë detyrimet e saj të lidhura me detyrimet financiare në momentin e pagesës. Risku i likuiditetit është risk i qenësishëm në biznesin e Shoqërisë pasi disa aktive specifike të blera apo detyrime të shitura mund të kenë karakteristika likuiditeti që janë specifike. Nëse Shoqërisë do ti duhet të ketë shuma të mëdha në një afat të shkurtër kohor që tejkalon kërkesat normale për mjete monetare mundet që të ndeshet me vështirësi për të siguruar çmime konkurruese. Shoqëria manaxhon riskun e likuiditetit duke monitoruar në mënyrë të vazhdueshme parashikimet dhe flukset monetare aktuale dhe duke u munduar të përputhë profilet e maturitetit të aktiveve dhe detyrime.

31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i Likuiditetit (vazhdim)

2017	0 - 12 muaj	2 - 5 vjet	Më tepër se 5 vjet	Totali
Aktive financiare				
Mjetet monetare në arkë dhe bankë	85,458	-	-	85,458
Llogarite e arketueshme	2,726,740	-	-	2,726,740
Aktive financiare gjithsej	2,812,198	-	-	2,812,198
Detyrime financiare				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	2,991,323	-	-	2,991,323
Detyrime ndaj personelit	57,164	-	-	57,164
Detyrime tatimore	23,062	-	-	23,062
Provizione	137,130	-	-	137,130
Huamarrje afatshkurter	1,804,645	-	-	1,804,645
Huamarrje afatgjata		1,354,429	4,127,484	5,481,913
Grante			465,222	465,222
Detyrime financiare gjithsej	5,013,324	1,354,429	4,592,706	10,960,459
Hendeku i maturitetit	(2,201,126)	(1,354,429)	(4,592,706)	(8,148,261)

Risku i monedhës

Shoqëria ndërmer transaksione në monedhë të huaj si pasojë e ekspozimit ndaj luhatjeve të kurseve të këmbimit. Ekspozimi ndaj kurseve të këmbimit manaxhohet duke përcaktuar një politikë midis të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve. Vlera kontabël neto e aktiveve dhe detyrimeve monetare të shoqërisë sipas monedhave për vitin që u mbyll janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

2017	LEK	EUR	USD	Total
Aktivet financiare				
Mjetet monetare në arkë dhe bankë	85,005	3	450	85,458
Llogarite e arketueshme	2,726,740	-	-	2,726,740
Totali aktive financiare	2,811,745	3	450	2,812,198
Detyrime financiare				
Llogarite e pagueshem dhe detyrime te perlllogaritura	2,991,323	-	-	2,991,323
Detyrime ndaj personelit	57,164	-	-	57,164
Detyrime tatimore	23,062	-	-	23,062
Provizione	137,130	-	-	137,130
Te tjera llogari te pagushme	1,008	-	-	1,008
Huamarrje afatshkurter	1,804,645	-	-	1,804,645
Huamarrje afatgjata		5,481,913	-	5,481,913
Grante	465,222	-	-	465,222
Totali detyrime financiare	5,479,554	5,481,913	-	10,961,467
Pozicioni valutor neto	(2,667,809)	(5,481,910)	450	(8,149,269)

(Vlerat janë në mijë Lek)

31. Manaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i monedhës (vazhdim)

Analiza e ndjeshmërisë së monedhës së huaj

Analiza e ndjeshmërisë përfshin vetëm zërat monetare të shprehura në monedhë të huaj në fund të vitit dhe një korigjim i vlerave të tyre i bërë për një 10% ndryshim në kurset e këmbimit. Vlera pozitive/negative tregojnë rritje/ulje në fitim ose në kapital që ndodh kur leku dobësohet/forcohet në vlerën e tij kundrejt monedhave të huaja me +/- 10%.

32. Vlera e drejtë e instrumentave financiare

Instrumentat financiarë përfshijnë aktivet dhe detyrimet financiare.

Aktivët financiarë përbëhen nga gjendja e llogarive në bankë dhe të arkëtueshmet. Detyrimet financiare përbëhen nga të pagueshmet.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare përfshihet në shumën në të cilën instrumenti mund të shkëmbehet në një transaksion mes palëve të gatshme, dhe jo të detyrueshme të në një proces likuidimi ose shitje. Vlerat e drejta të të gjitha aktiveve financiare të shoqërisë përafrjnë vlerat e tyre kontabël kryesisht për shkak të maturimit afatshkurtër të këtyre instrumentave.

33. Burimet kryesore në vlerësimin e pasigurisë

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Një vlerësim i shumës së mbledhshme të llogarive të arkëtueshme tregtare kryhet kur arkëtimi i shumës së plotë nuk është më e mundur. Për shumat individuale të rëndësishme, ky vlerësim është kryer në baza individuale. Shumat të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht, por që janë të vonuara, vlerësohen në mënyrë specifik dhe aplikohet një provizion në përputhje me gjatësinë e kohës së vonuar, bazuar në normat historike të rikuperimit.

34. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj.

Bashkia Kamez nuk e ka pranuar vendimin e Asamblese së Përgjithshme të Aksionereve të Shoqërisë UKT sh.a "Për miratimin e Projektmarreveshjes dhe Raportit të ndarjes së aksionareve Bashkia Vore dhe Kamzez nga shoqëria Ujësjetllës Kanalizime Tirane sh.a." dhe ka hapur proces gjyqësor për pavlefshmerinë e këtij vendimi. UKB Kamza nuk ka marrë në dorezim asetet dhe ato janë të pasqyruara në bilancin e UKB Tirane. Në datën 21 mars 2018 Gjykata e Shkalles së Parë Tirane vendosi pranimin e pëshem të kërkesë padisë. Në datën 26 prill 2018 ky vendim është ankimuar nga Ujësjetllës Kanalizime Tirane sh.a.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

35. Ngjarje pas datës së raportimit financiar

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pas datës së raportimit të cilat do të kërkonin korigjim ose shënime në pasqyrat financiare.